

DORACAQ



Numri Standard Ndërkombëtar i Muzikës

Titulli i origjinalit:

ISMN Users' Manual

E drejta e autorit në origjinal:

© International ISMN Agency

Ky është përkthimi i dytë në gjuhën shqipe i doracakut të ISMN-së, i cili bazohet në versionin e katërt të doracakut në gjuhën angleze i redaktuar dhe i botuar nga Agjencia Ndërkombëtare e ISMN-së në vitin 2008 (ISBN 978-92-990051-0-1).

Titulli i përkthimit:

Doracak

Numri Standard Ndërkombëtar i Muzikës

E drejta e autorit në shqip:

© 2015 Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

Përktheu:

Besim J. Kokollari

Redaktorë:

Edona Munishi - Kokollari

Fazli Gajraku

Botues:

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”
Prishtinë, 2015

Përmbajtja

<i>Parathënie</i>	7
<i>1. Historiku</i>	9
1.1. Nociione dhe përkufizime.....	10
2. <i>Struktura e Numrit Standard Ndërkombëtar të Muzikës (ISMN)</i>	11
2.1. Elementet identifikuese	11
2.1.1. Elementi i prefiksit	11
2.1.2. Elementi i botuesit	12
2.1.3. Elementi i ekzemplarit	12
2.1.4. Shifra e kontrollit	13
2.2. Numri i shifrave në secilin element dhe si të dallohen brenda një numri të ISMN-së	13
3. <i>Fushëveprimi i ISMN-së</i>	15
4. <i>Parimet dhe procedurat që duhet të ndiqen nga ana e botuesve gjatë numërimit të botimeve të tyre</i>	16
4.1. Caktimi i elementit të botuesit	16
4.2. Autoriteti	17
4.3. Përgjegjësia	17
4.4. Regjistri	17
4.5. ISMN-ja si numër i porosisë ose i edicionit	17
5. <i>Botuesit që nuk dëshirojnë t'i marrin përgjegjësitë për numërimin e botimeve të veta</i>	18
6. <i>Aplikimi i ISMN-së</i>	19
6.1. Faksimilet e shtypura dhe botimet në mikroformë	20

6.2.	Lidhjet e ndryshme të veprave muzikore	20
6.3.	Formatet e ndryshme	21
6.4.	Versione të ndryshme	24
6.5.	Botimet shumëvëllimëshe	25
6.6.	Botimet me materiale shoqëruese	25
6.7.	Antologjitë dhe ekstraktet	26
6.8.	Veprat e botuara më herët	26
6.9.	Të drejtat e blera nga botuesit e tjerë	27
6.10.	Botimet e përbashkëta	27
6.11.	Muzika që shitet apo shpërndahet përmes agentëve	27
6.12.	Botuesit që veprojnë në më shumë se një vend me veprimtarinë e tyre botuese	28
6.13	Ndalimi i përdorimit të sërishëm të një numri të ISMN-së	28
7.	<i>Shtypja dhe promovimi i ISMN-së</i>	29
7.1.	Shtypja e ISMN-së në veprat muzikore	29
7.2.	Shtypja e ISMN-së në kod të lexueshëm prej pajisjeve kompjuterike	32
7.3.	Furnizimi me barkode 13-shifrore Udhëzime për prodhuesit e etiketave të barkodeve	33
7.4.	Promovimi i ISMN-së	34
8.	<i>Administrimi i sistemit të ismn-së</i>	34
8.1	Administrimi ndërkombëtar	34
8.2	Administrimi kombëtar ose rajonal	37
9.	<i>ISMN-ja dhe numrat e tjerë standardë ndërkombëtarë</i>	40
9.1.	ISBN-ja	40
9.2.	ISSN-ja	41
9.3.	ISRC-ja	42
9.4.	ISWC-ja	43
9.5.	ISAN-i	44

9.6.	DOI	45
9.7.	URN-ja	45
10.	<i>Shtojca: ISMN-ja dhjetë shifrore</i>	47
10.1.	Rifomatizim i ISMN-së	47
	<i>Shtojca</i>	48
A.	Rrjeti i standardeve	48
B.1.	Metadatat minimale për ISMN-në	49
B.2.	ONIX-i	50

Parathënie

ISMN-ja (Numri Standard Ndërkombëtar i Muzikës) ka qenë mjaft e suksesshme gjatë këtyre pesëmbëdhjetë vjetëve prej se është themeluar. Dyzet e shtatë anëtarë aktivë të agjencive të ISMN-së, të cilët përfaqësojnë më shumë se kaq shtete e rajone, janë pjesë e sistemit të ISMN-së. Po të donim diçka më shumë nga ISMN-ja, ajo do të ishte që ISMN-ja të gjente aplikim më të madh në veprimtarinë afariste muzikore njëjtë si ISBN-ja. Veprimtaria botuese dhe shfrytëzimi i veprave muzikore nuk është se krahasohet lehtë me botën e librit – kjo veprimtari merret me një audiencë të përzgjedhur dhe të shkolluar - dhe se strukturat historike dallojnë në vende me veprimtari të madhe muzikore. Në ditët e sotme shihet deri diku një globalizim përmes shtimit të furnizuesve në internet, të cilët ofrojnë sasi të madhe të veprave muzikore, dhe si rrjedhojë e mbulojnë zbrazëtinë që ekziston ndërmjet vendeve me traditë muzikore dhe të dashamirësve të muzikës nga e mbarë bota. ISMN-ja do të ishte identifikuesi ideal për materialet në internet, meqë përkon me sisteme edhe më të specializuara të identifikimit.

Ky edicion i ri i *Doracakut* të ISMN-së erdhi si rezultat i korrigjimeve të bëra në vetë standardin e ISMN-së (ISO 10957) në të cilin u ndërrua formati i numrit të muzikës prej 10 shifrave në 13 sosh. Ky ndryshim u bë në marrëveshje me ISBN-në.

Doracakët për përdorues për nga vetë natyra e tyre nuk janë statik - ata ndryshojnë, korrigjohen e përmirësohen vazhdimisht me qëllim që të jenë të dobishëm dhe t'u përshtaten nevojave të reja. Andaj nuk ka pikë dyshimi se edhe ky edicion nuk do të jetë i fundit. Dhe se versionin më të ri të doracakut do ta gjeni gjithmonë në ueb-sajtin e Agjencisë Ndërkombëtare të ISMN-së në: <http://ismn-international.org>.

Berlin, 3 prill 2008

Hartmut Walravens

1. HISTORIKU

Kur ISBN-ja filloi të përdorej gjerësisht në tregun e librit, botuesit e muzikës filluan menjëherë të kërkonin një numër standard të ngjashëm për identifikimin e veprave muzikore. Diskutimet ishin më kundërtënëse sidomos kur bëhej fjalë nëse për identifikim do të mjaftonte një numër i thjeshtë, apo një kod bibliografik, i cili e përfaqësonte, mes të tjerash, lidhjen midis partiturës dhe pjesëve individuale. Dega e Shoqatës Ndërkombëtare të Bibliotekarëve të Muzikës, Arkivave dhe e Qendrave të Dokumentimit¹ në Mbretërinë e Bashkuar iu drejtua Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së me propozimin që identifikuesi të jetë një numër dhjetëshifrorë pa kod bibliografik; kjo skemë pastaj u botua në revistën e ISBN-së dhe u përkrah njëzëri gjithandej nëpër botë. ISO/TC 46 e pranoi zyrtarisht projekt-propozimin si dokument pune; ndërsa botuesit dhe ekspertët evropianë dhe amerikanë pas diskutimeve intensive arritën marrëveshje lidhur me këtë skemë në takimin e ekspertëve evropianë dhe amerikano-veriorë në Otavë. Argumentet kryesore që ndikuan në heqjen e idesë së mëparshme për të pasur kod bibliografik kishin të bënin kryesisht me përvojën afatgjate dhe të qëndrueshme të ISBN-së, si dhe me opsionin që numri dhjetëshifrorë të përfshihej në sistemin ndërkombëtar 13-shifrorë të barkodit, duke ia shtuar thjesht prefiksin e vendit fiktiv të rezervuar për libra, periodikë dhe vepra muzikore².

Projekt-propozimi për numrin e ISMN-së u shqyrtua shpejt nga grupi punues i ISO-s dhe u zyrtarizua në fund të vitit 1993 me ç'rast edhe u botua si standard në Gjenevë.

¹ Anglisht: International Association of Music Librarians, Archives and Documentation Centers (IAMLC)

² Ky prefiks i vendit fiktiv prej 3 shifrave u rezervua nga EAN (që tani njihet si GS1) dhe u quajt në anglisht si "Bookland".

ISMN-ja është një sistem racional që përdoret në veprimtarinë botuese muzikore, në tregun muzikor, si dhe në bibliotekat muzikore.

Sistemi i ISMN-së përbëhej në fillim prej një numri dhjetëshifrorë (shih seksionin 10. Shtojca – ISMN-ja dhjetëshifrore). Prej vitit 2008, ISMN-ja u shndërrua në një sistem trembëdhjetëshifrorë. ISMN-ja nis me një prefiks të EAN-it <<979>> dhe pasohet prej një <<0>> (zero). Zeroja <<0>> shërben si zëvendësim i shkronjës <<M>> që përdoret në sistemin dhjetëshifrorë të ISMN-së. Secili numër trembëdhjetëshifrorë i ISMN-së fillon me 979-0.

Ndryshe prej ISBN-së, në standardin e ISMN-së nuk ekziston ndonjë numër grupor meqë muzika është ndërkombëtare.

Një numër dhjetëshifrorë i ISMN-së në rast të shndërrimit në ISMN trembëdhjetëshifrorë e ruan numrin e njëjtë të kontrollit. (Vëreni: kjo ndryshon në rast të shndërrimit të ISBN-së dhjetëshifrore në ISBN trembëdhjetëshifrore, me ç'rast duhet të bëhet përlogaritja e serishme e numrit të kontrollit.)

1.1. Nacione dhe përkufizime

Nacionet dhe përkufizimet e dhëna në vijim i kanë këto domethënie në këtë dokument.

Edicion: Të gjitha kopjet e një vepre muzikore, të cilat prodhohen prej përmbajtjes pothuaj të njëjtë, përkatësisht origjinale, si dhe botohen prej personit të njëjtë, subjektit të njëjtë apo grupit të njëjtë të subjekteve. Këtu përfshihen materialet që botohen për t'u shitur, dhënë me qira, gratis ose edhe vetëm për qëllim të mbrojtjes të së drejtës autoriale.

Ekzemplar: Një botim i një vepre muzikore, apo i një pjesë të saj, e cila vihet në dispozicion si e veçantë.

Vepër muzikore: Paraqitje grafike(p.sh. me nota) e muzikës në çfarëdo formati, (p.sh. partiturë – nuk përfshihen librat muzikorë)

2. STRUKTURA E NUMRIT STANDARD NDËRKOMBËTAR TË MUZIKËS (ISMN)

Një Numër Standard Ndërkombëtar i Muzikës (ISMN) përbëhet prej prefiksit <<979-0>>, i cili pasohet prej nëntë shifrave të tjera. Kurdoherë që shtypet ose shkruhet, numri duhet të paraprihet prej shkronjave <<ISMN>>

Në vendet ku nuk përdoret alfabeti latin mund të përdoret shkurtesa në shkrimin e atij vendi krahas shkronjave <<ISMN>>në alfabetin latin.

2.1. Elementet identifikuese

ISMN-ja, si numër, ndahet në katër grupe elementesh, dy prej të cilave kanë gjatësi të ndryshueshme. Kur shtypet ISMN-ja, atëherë elementet ndahen me vizë apo me hapësirë. Këto katër grupe elementesh janë:

2.1.1. Elementi i prefiksit

Prefiksi <<979-0>> e dallon ISMN-në prej ISBN-së. Shifra 979 e përfaqëson fushën e vendit fiktiv në kuadër të sistemit të barkodit të EAN (GS1), ndërsa <<0>> e paraqet numrin e parë nga dhjetë sa janë të përcaktuar për ISMN-në.

2.1.2. Elementi i botuesit

Ky element e identifikon një botues të veçantë. E identifikon botuesin e një vepre të caktuar muzikore. Botuesve që kanë veprimtari më të madhe botuese u caktohen elemente më të shkurtra të identifikimit të botuesve, ndërsa botuesve me veprimtari më të vogël u caktohen elemente më të gjata të identifikimit të botuesve (shih seksionin 2.2.).

2.1.3. Elementi i ekzemplarit

Ky element e identifikon edicionin e një vepre muzikore, i cili mund ta përfaqësojë një partiturë, një partiturë në miniaturë (ndryshe e njohur edhe si partiturë xhepi), një komplet të pjesëve për instrumentet me frymë, një pjesë për obo, etj. Një ekzemplar, nga këndvështrimi i ISMN-së, është pjesë e veprimtarisë botuese në fushën e muzikës, i cila mund të shitet, të blihet, ose t'i qasemi përmes teknologjisë në mënyrë të veçantë prej pjesëve të tjera.

Elementi identifikues i ekzemplarit i caktohet një ekzemplari të veçantë nga ana e botuesve brenda serisë së numrave që u janë caktuar vetë atyre. Gjatësia e elementit të ekzemplarit varet prej gjatësisë së elementit të botuesit.

Në rrethana normale elementi i identifikimit të ekzemplarit caktohen nga vetë botuesit (për botuesit që nuk dëshirojnë ta marrin këtë përgjegjësi, shih seksionin 5.). Botuesit të cilët i caktojnë vetë elementet e ekzemplarëve të tyre mund t'i shfrytëzojnë këta numra gjatë tërë fazave të planifikimit, pastaj edhe për ekzemplarët që i botojnë vetëm për t'i dhënë me qira, etj.

2.1.4. Shifra e kontrollit

Shifra e kontrollit llogaritet duke u bazuar në faktorin 10, ku secili numër i ISMN-së shumëzohet me masën 1 dhe 3 që radhiten nga e majta e ISMN-së, i cila fillon me numrin 9, në të djathtë.

Kjo do të thotë që secili prej dymbëdhjetë shifrave të para të ISMN-së (duke e përjashtuar vetë shifrën e kontrollit) shumëzohet me numrat 1 dhe 3 të renditur njëri pas tjetrit nga e majta në të djathtë. Shuma e dhënë plus shifra e kontrollit duhet të jenë të përpjesëtueshëm me 10 pa mbetje. Për shembull:

	Elementi i prefiksit	Elementi i botuesit	Elementi i ekzemplarit	Shifra e kontrollit
	9 7 9 0	3 4 5 2	4 6 8 0	5
Masa	1 3 1 3	1 3 1 3	1 3 1 3	
Rezultati	9 21 9 0	3 12 5 6	4 18 8 0	= 95

Gjithsej $95 + 5 = 100 \rightarrow 5 =$ shifra e kontrollit

Meqë 100 mund të pjesëtohet me 10 pa mbetje, atëherë 979-0-3452-4680-5 është një numër i vlefshëm i ISMN-së.

2.2. Numri i shifrave në secilin element dhe si të dallohen brenda një numri të ISMN-së

Numri i shifrave të botuesit dhe të elementeve të ekzemplarit është i ndryshueshëm, edhe pse numri i përgjithshëm i këtyre shifrave brenda këtyre elementeve gjithmonë mbetet tetë. Këto tetë shifra së bashku me prefiksin <<979-0>> dhe me

shifrën e kontrollit e përbejnë numrin trembëdhjetëshifrorë të ISMN-së.

Botuesve që pritet të kenë veprimtari të madhe botuese u caktohen numrat prej tri ose katër shifrave. Botuesve që pritet të kenë veprimtari të vogël botuese u caktohen numrat prej pesë, gjashtë ose shtatë shifrave. Në tabelën në vijim shihet sesi janë aranzhuar elementet e botuesit në raport me totalin e numrave në dispozicion për identifikimin e ekzemplarëve:

Elementi i botuesit	Totali i numrave në dispozicion për identifikimin e ekzemplarëve
000 - 099	100000
1000 - 3999	10000
40000 - 69999	1000
700000 - 899999	100
9000000 - 9999999	10

Katër grupet e elementeve të numrit të ISMN-së ndahen me hapësirë ose me vizë mes veti në mënyrë që të lexohen më lehtë në rastin kur shtypen në ekzemplar. Megjithatë, këto hapësira, apo ndarje, nuk ruhen në sistemet kompjuterike, meqë i njohin elementet si një varg numrash me gjatësi të kufizuar.

Nëse e analizojmë numrin e ISMN-së 9790299102349, mund të shohim se nuk mund të kemi ndonjë botues brenda këtij numri me identifikuesin 299 ose 29910. Por mund të kemi një botues i cili identifikohet me numrin 2991. Po t'i hedhim një vështrim vargut të numrave identifikues të elementeve të botuesve më lartë do të shohim se në këtë numër të ISMN-së elementi i botuesit duhet të jetë 2991.

3. FUSHËVEPRIMI I ISMN-SË

ISMN-ja përdoret për t'i identifikuar botimet e veprave muzikore pa marrë parasysh nëse shiten, jepen me qira, falen apo për qëllim të mbrojtjes të së drejtës autoriale.

ISMN-ja nuk përdoret për identifikimin e incizimeve me zë apo videove (përveç në raste të rralla siç e kemi cekur më poshtë): incizimet e veçanta me zë identifikohen me Kodin Standard Ndërkombëtar të Incizimeve (ISRC), ndërsa veprat audio-vizuale me anë të Numrit Standard Ndërkombëtar Audio-vizual (ISAN). ISMN-ja nuk përdoret për libra që trajtojnë tema të fushës së muzikës, e të cilat identifikohen me Numrin Standard Ndërkombëtar të Librit (ISBN) (shih seksionin 9 për aplikimin e llojeve të ndryshme të numrave standardë).

Secila pjesë përbërëse e një botimi, e cila është në dispozicion si e veçantë, duhet ta marrë numrin e vet të ISMN-së. Ekzemplarët që duhet të numërohen me numër të ISMN-së janë:

- Partiturat
- Partiturat në miniaturë/mësimore
- Partiturat vokale
- Komplete të pjesëve
- Pjesët individuale, që janë në dispozicion si të veçanta
- Pop foliot³
- Antologjitë
- Mediet e tjera që janë pjesë integrale e një veprë muzikore (p.sh. një kasetë, e cila është <<pjesë>> e një kompozimi)

³ Foliot e muzikës popullore, apo pop-foliot, janë transkriptime të incizimeve dhe vihen në dispozicion apo shiten si partiura për zë e piano.

- Komentarë të botuar me vepra muzikore (që janë në dispozicion edhe si të veçantë)
- Libra të këngëve (opsionale) (shih seksionin 9.1)
- Botime të veprave muzikore në mikroforma
- Botime të veprave muzikore në braj
- Botime elektronike të veprave muzikore

Për librat dedikuar muzikës, shih listën në vijim.

Botimet që nuk marrin ISMN janë:

- Librat që trajtojnë tema muzikore, përveç nëse përmbajnë shembuj me nota muzikore
- Incizimet zanore a videot që nuk janë pjesë e ndonjë vepre muzikore (duke përfshirë edhe incizimet që janë në dispozicion përmes medimeve kompjuterike)
- Periodikët dhe botimet serike si tërësi, që dallojnë prej vëllimeve individuale në një botim serik (shih seksionin 9.2.)

4. PARIMET DHE PROCEDURAT QË DUHET TË NDIQEN NGA ANA E BOTUESVE GJATË NUMËRIMIT TË BOTIMEVE TË TYRE

4.1. Caktimi i elementit të botuesit

Agjencia kombëtare ose rajonale e ISMN-së ia cakton elementin e identifikimit një botuesi të caktuar, dhe e cakton vargun e elementit të ekzemplarëve që do t'i jepen në dispozicion atij botuesi. Numri i elementeve për identifikimin e ekzemplarëve varet prej gjatësisë së elementit identifikues të botuesit. Botuesit duhet të sigurohen që agjencia e ISMN-së t'i posedon informatat e mjaftueshme sa i përket listave të tyre të

mëparshme të botimeve të cilat planifikojnë t'i botojnë, si dhe të planeve aktuale dhe të ardhme të botimeve me qëllim që atij botuesi t'i caktohet një element i përshtatshëm i identifikimit. (Për botuesit që e ushtrojnë veprimtarinë në më shumë se një vend të botimit, shih seksionin 6.12.)

4.2. *Autoriteti*

Botuesit janë vetë përgjegjës për t'ia caktuar botimeve të tyre elementin e identifikimit të ekzemplarëve. Rekomandohet që ISMN-ja t'i caktohet ekzemplarëve në rastin kur dihet koha e botimit të tyre.

4.3. *Përgjegjësia*

Botuesit duhet ta emërojnë një person përgjegjës për t'ua caktuar numrat e ISMN-së botimeve të veta, si dhe për t'i zbatuar rregullat e parapara me këtë standard.

4.4. *Regjistri*

Secili botues duhet të kujdeset dhe ta ruajë regjistrin e ISMN-ve që iu kanë caktuar botimeve të veta. Regjistri duhet t'i ketë këto informata: ISMN-në, autorin, titullin dhe formatin (kurdoherë që kjo është e mundur).

4.5. *ISMN-ja si numër i porosisë ose i edicionit*

Botuesit mund ta shfrytëzojnë apo ta përshtatin ISMN-në si numër të porosisë apo të edicioneve të botimeve. Botuesit, të cilët dëshirojnë t'i ruajnë numrat e mëparshëm të porosisë ose të edicioneve, krahas ISMN-së, do të duhet të jenë në gjendje ta bëjnë dallimin/apo konvertimin midis sistemeve të ndryshme të numërimit.

5. BOTUESIT QË NUK DËSHIROJNË T’I MARRIN PËRGJEGJËSITË PËR NUMËRIMIN E BOTIMEVE TË VETA

Nëse ndonjë botues me dëshirë apo për ndonjë arsye tjetër nuk e merr përgjegjësinë e caktimit të ISMN-së për botimet e veta, atëherë agjencisë kombëtare apo rajonale të ISMN-së i mbeten dy alternativa:

(1)

Agjencia kombëtare mund ta rezervojë një seri numrash për botues të ndryshëm, dhe t’ua vë të gjithë titujve të tyre numrat e ISMN-së që dalin prej asaj serie të numrave pa marrë parasysh se cili është botuesi. Në një rast të tillë, numri i ISMN-së nuk do ta identifikojë botuesin e një titulli të veçantë.

Këshillohet që kjo procedurë të rezervohet për botuesit të cilët botojnë ndonjë titull aty-këtu, dhe të cilët ka gjasa që asnjëherë të mos jenë në gjendje t’i marrin vetë përgjegjësitë e numërimit të ekzemplarëve të tyre.

(2)

Agjencia kombëtare mund ta marrë vetë përgjegjësinë e caktimit të elementit të identifikimit të botuesit, ta ndajë një seri numrash të ISMN-së që lidhen me atë element të botuesit, t’ia caktojë numrin e ISMN-së secilit botim të botuesit në fjalë, si dhe ta informojë botuesin për numrin e ndarë para se ai ta botojë veprën.

Në raste të tilla, dhe nëse botuesi pajtohet që ta bëjë një gjë të tillë, ISMN-ja mund të shtypet në edicionin e botimit. Supozohet se një botues i tillë do t’i marrë më vonë të gjitha përgjegjësitë për t’i caktuar numrat e vet të ISMN-së.

6. APLIKIMI I ISMN-SË

Secilit edicion të botimit të një ekzemplari duhet t'i caktohet një numër i veçantë i ISMN-së. Në veçanti, një numër i ri i ISMN-së është i domosdoshëm kur:

- ka ndonjë ndryshim në përmbajtjen muzikore ose letrare të një vepre, përveç nëse këto janë përmirësime të vogla.
- ndryshohet teksti letrar që është pjesë integrale e një vepre muzikore.
- i shtohet, i hiqet ose i ndryshohet përkthimi një teksti letrar. Një numër i ri i ISMN-së i shtohet edhe kur teksti dhe/ose muzika nuk pësojnë ndonjë ndryshim.
- ndryshon dukshëm madhësia fizike e ekzemplarit me qëllim që të botohet një edicion i ri i partiturave në miniaturë, përkatësisht të xhepit.

Botimi i pandryshuar apo tirazhi i ri i ekzemplarit të njëjtë në formatin e njëjtë dhe nga i njëjti botues nuk duhet të marrë numër të ri të ISMN-së (përveç nëse ka ndryshime në lidhjen e tij siç përcaktohet në seksionin 6.2.). Po kështu, çfarëdo vepre e riprodhuar me kërkesë nga origjina e njëjtë nuk duhet të marrë numër të ri të ISMN-së, edhe nëse vepra e riprodhuar mund të dalë me një datë të re të riprodhimit.

Ndryshimet në çmim po ashtu nuk kërkojnë që ekzemplari të marrë numër të ri të ISMN-së.

6.1. *Faksimilet e shtypura dhe botimet në mikroformë*

Një faksimile e shtypur e cila nxirret prej një botuesi tjetër duhet të marrë numër të veçantë të ISMN-së.

Një edicion në mikroformë duhet të marrë gjithmonë numër të ri të ISMN-së.

6.2. *Lidhjet e ndryshme të veprave muzikore*

Secili ndryshim në lidhje i një titulli të botuar, edhe nëse përm-bajtja është e njëjtë, kualifikohet të ketë numër të veçantë të ISMN-së. Për shembull, një botim me kopertina të forta dhe një me të buta marrin secili veç e veç ISMN të ndryshme.

Partiturë (me lidhje të butë)	
Partiturë dhe komentat ⁴ (të vendosur në një kuti)	
Partiturë vokale (me lidhje të butë)	
Partiturë vokale (lidhje me pëlhurë)	= 4 numra të ISMN-së
Partiturë instrumentale (me lidhje të butë)	
Partiturë instrumentale (pa kopertina)	
	= 2 numra të ISMN-së

Nuk kualifikohet për numër të ri të ISMN-së nëse është bërë ndonjë ndryshim në dizajnin e kopertinës, ndërsa përmbajtja e ekzemplarit nuk ka ndryshuar, ose është bërë ndonjë

⁴ Komentarët zakonisht ofrojnë informata shtesë lidhur me muzikën apo kompozitorin, etj.

ndryshim në ngjyra apo dallime anësore të tjera mes lidhjes së një botimi dhe botimit vijues, dhe të cilat nuk përbëjnë si të tilla ndryshim të lidhjes. (Për formatet e ndryshme të veprave muzikore në formatin elektronik shih seksionin 6.3.8.)

6.3. *Formatet e ndryshme*

Secila pjesë përbërëse e një botimi, e cila mund të shitet apo të sigurohet si e veçantë duhet të marrë numër të ri të ISMN-së.

Këshillohet që lista e plotë e numrave të ISMN-së, e cila u është caktuar pjesëve të tilla përbërëse të një botimi, të shtypet/shkruhet në një rën apo në disa pjesë të tilla (shih seksionin 7.1.).

6.3.1. *Partiturat dhe pjesët*

Një botim, i cili përbëhet prej partiturave dhe pjesëve, partitura si tërësi, kompleti i pjesëve si tërësi, dhe secila pjesë veç e veç (nëse janë të ndara) duhet ta ketë ISMN-në e vet:

Partiturë	= 4 numra të ISMN-së
Partiturë vokale	
Komplet i pjesëve të një kori	
Pjesë individuale të një kori	

6.3.2. *Partiturat që janë pjesë të një kompleti*

Kur një partiturë gjendet vetëm si ekzemplar brenda një kompleti dhe jo si ekzemplar më vete që mund të shitet veçmas, atëherë ajo partiturë duhet ta marrë numrin e ISMN-së së kompletit:

Partiturë për piano dhe dy pjesë si një komplet	= 1 numër të ISMN-së
---	----------------------

Megjithatë, nëse partitura më vonë bëhet pjesë më vete e veçantë, atëherë asaj duhet t'i caktohet ISMN-ja e vet.

Kur një partiturë është edhe si pjesë e veçantë edhe si pjesë e një kompleti, atëherë asaj duhet t'i caktohet ISMN-ja e vet.

Partiturë	= 2 numra të ISMN-së
Partiturë dhe pjesë, komplet	

Partitura do ta marrë një numër të ISMN-së, ndërsa kompleti një tjetër.

6.3.3. Pjesët të cilat janë në dispozicion si të ndara

ISMN-ja duhet t'i caktohet secilës pjesë të veçantë, dhe të cilën e gjejmë si ekzemplar të botuar veçmas.

Pjesë për violinë I	= 4 numra të ISMN-së
Pjesë për violinë II	
Pjesë për violë	
Pjesë për violonçel	

6.3.4. Pjesët të cilat janë edhe të ndara edhe në komplet

Kur pjesët e shtypura veçmas janë edhe pjesë e kompletit edhe i gjejmë si ekzemplarë të veçantë, atëherë kompleti duhet ta ketë ISMN-në e vet ashtu siç duhet ta kenë edhe secila pjesë e shtypur e veçantë.

Pjesë për violinë	
Pjesë për violë	
Pjesë për violonçel	
Kompleti i pjesëve	

6.3.5. Pjesët të cilat i gjejmë vetëm si komplet

Kur pjesët individuale instrumentale ose vokale nuk i gjejmë si të veçanta, por vetëm si komplet, atëherë ISMN-ja duhet t'i caktohet kompletit, dhe secila pjesë e shtypur veçmas duhet ta marrë ISMN-në e cila iu ka caktuar kompletit:

Partiturë	
Kompleti i pjesëve	

Partitura do ta marrë ISMN-në e vet; secila pjesë individuale do ta marrë ISMN-në e atij kompletit.

Vërejtje: pjesët individuale, të cilat janë pjesë e kompletit, duhet ta marrin secila ISMN-në e vet nëse dhe kurdo që ato dalin si ekzemplarë të veçantë.

6.3.6. Disa pjesë janë të ndara, disa vetëm si komplete

Kur disa prej pjesëve të shtypura veçmas brenda një kompletit gjenden si të veçanta dhe disa prej tyre si komplet, secila pjesë e veçantë duhet ta ketë numrin e vetë të ISMN-së si ekzemplar i veçantë që është; të gjitha pjesët e tjera e marrin numrin e ISMN-së i cili i caktohet kompletit që i përkasin:

Partiturë	= 6 numra të ISMN-së
Komplet i të gjitha pjesëve	
Komplet për instrumente pa tela	
Pjesë për violinë I	
Pjesë për violinë II	
Pjesë për violonçel/bas	

6.3.7. *Pako me shumë kopje*

Kur një ekzemplar të veçantë e gjejmë po ashtu edhe si pako që përmban kopje të shumta të një ekzemplari, atëherë pakoja duhet ta ketë numrin e vet unik të ISMN-së:

Fletushkë, një kopje	= 2 numra të ISMN-së
Fletushkë, pako prej 100 kopjesh	

6.3.8. *Formatet elektronike*

Veprat muzikore në formatin elektronik do të trajtohen njëjtë si materialet e shtypura. Nëse ka opsione të ndryshme të shkarkimit për formate të ndryshme, atëherë do të këshillojmë përdorimin e numrave të ndryshëm të ISMN-së për to me qëllim që t'i shmangemi pështjellimit.

6.4. *Versione të ndryshme*

Nëse një botues e boton një titull në më shumë sesa në një aranzhim apo version, atëherë secili aranzhim apo version duhet ta ketë numrin e vet unik të ISMN-së:

Piano solo	= 3 numra të ISMN-së
Piano – version duet	
Organ solo – aranzhim	
Zë i lartë	= 2 numra të ISMN-së
Zë i mesëm	

6.5. *Botimet shumëvëllimëshe*

Një numër i ISMN-së duhet t’i caktohet tërë kompletit të vëllimeve të një botimi shumëvëllimësh, si dhe secilit vëllim të veçantë në komplet (shih seksionin 9.2.):

Vëllimi I – III (komplet)	= 4 numra të ISMN-së
Vëllimi I	
Vëllimi II	
Vëllimi III	

Partiturë dhe komentare kritik (komplet)	= 3 numra të ISMN-së
Partiturë	
Komentare kritik (gjendet e veçantë)	

Nëse njëri prej vëllimeve është tekst i shtypur, atëherë ai mund ta marrë numrin e ISBN-së.

6.6. *Botimet me materiale shoqëruese*

Kur një vepër muzikore e ka një material shoqërues, si tekst këngësh, komentare, apo të ngjashme, që janë botuar si të veçanta, dhe nëse ekzemplarët shiten vetëm si një pako, atëherë ekzemplari shoqërues duhet ta marrë numrin e njëjtë të ISMN-së si të vëllimit të cilin e shoqëron.

Partiturë	
Komentar kritikë, nuk gjendet si i veçantë	= 1 numër të ISMN-së
Pjesë zëri dhe për instrumente me tastierë	
Vepër me tekst këngësh ⁵ , nuk gjendet si i veçantë	= 1 numër të ISMN-së

Nëse materiali shoqëruet shitet edhe si i veçantë edhe si pako, atëherë botimi duhet të trajtohet sikur të ishte botim shumëvëllimësh (shih seksionin 6.5).

6.7. *Antologjitë dhe ekstraktet*

Antologjitë dhe ekstraktet duhet ta kenë numrin e tyre unik të ISMN-së pa marrë parasysh nëse ekzemplari në antologji apo vepra më e madhe kanë qenë të botuara më parë apo ka kohë që kanë dalë prej shtypit.

Numri i ISMN-së i cili iu ka caktuar një ekzemplari individual në një kontekst të mëhershëm mund të paraqitet në botimin e ri - për shembull, në fund të faqes së parë të secilës pjesë muzikore. ISMN-të e tilla duhet të dallohen qartë prej ISMN-së së botimit të ri.

6.8. *Veprat e botuara më herët*

Botuesit luten që t'u vënë numra të ISMN-së veprave të botuara më herët dhe t'i botojnë këta numra në katalogët e tyre. Gjithashtu numri i ISMN-së duhet të shtypet në ribotimin e parë të një veprë që ka qenë pjesë e botimeve të mëhershme.

⁵ Këto vepra kryesisht paraqiten me nota muzikore, ndërsa nën pentagram vendoset teksti i këngës

6.9 *Të drejtat e blera nga botuesit e tjerë*

Në rastin kur një botues, duke e përfshirë edhe ndonjë agjent i cili e ka vetëm të drejtën e shitjes, ia ka blerë një botuesi tjetër të drejtën e veprës muzikore dhe e boton atë vepër në kuadër të veprimtarisë së tij botuese, atëherë botuesi i ri duhet t'ia caktojë atij botimi një numër ri të ISMN-së. Nëse këtë të drejtë e kanë blerë disa botues, secili do t'ia caktojë numrin e vet të ISMN-së për territorin ku vepron.

6.10 *Botimet e përbashkëta*

Kur një botim botohet së bashku me një ose me disa botues, atëherë secili prej tyre mund t'ia vë numrin e vet të ISMN-së. Numrat e ISMN-së të të gjithë botuesve të përmendur në vepër duhet të shtypen në ekzemplar dhe të identifikohen qartë prej njëri-tjetrit. Vetëm numri i ISMN-së së botuesit përgjegjës për shpërndarjen e veprës do të paraqitet si barkod në botim.

6.11 *Muzika që shitet apo shpërndahet përmes agjentëve*

Sipas parimeve të sistemit të ISMN-së, një edicion i caktuar i një botimi, i cili botohet prej një botuesi të caktuar, duhet ta marrë vetëm një numër të ISMN-së. Ky numër i ISMN-së duhet të mbetet në atë botim pa marrë parasysh se kush merret me shitjen dhe shpërndarjen e veprës muzikore. Shpërndarësi mund t'ia caktojë veprës një numër të ri vetëm në rrethana të veçanta, si vijon:

- kur një vepër muzikore importohet prej një shpërndarësi apo agjenti ekskluziv që vjen prej një territori që ende nuk është inkuadruar në sistemin e ISMN-së, dhe si rrjedhojë vepra nuk ka numër

të ISMN-së. Në këtë rast, shpërndarësi mund t'ia caktojë veprën në fjalë një numër të ISMN-së.

- kur një vepër muzikore importohet prej disa shpërndarësve prej një territori që ende nuk është inkuadruar në sistemin e ISMN-së, dhe si rrjedhojë vepra nuk ka numër të ISMN-së. Në këtë rast, agjencia rajonale ose kombëtare duhet t'ia caktojë veprën në fjalë një numër të ISMN-së që e lidh me ata shpërndarës.

6.12. Botuesit që veprojnë në më shumë se një vend me veprimtarinë e tyre botuese

Një botues i cili vepron në disa vende, të cilat radhiten në veprën e botuar, do t'ia caktojë ekzemplarit vetëm një numër të ISMN-së.

Një botues i cili udhëheq me zyra ose degë të ndryshme dhe të veçanta në vende të ndryshme mund të ketë nga një element të botuesit për secilën zyrë ose degë. Megjithëkëtë, secili ekzemplar duhet ta ketë vetëm një ISMN, dhe se ky numër duhet të caktohet nga zyra ose dega përgjegjëse për atë botim.

6.13. Ndalimi i përdorimit të sërishëm të një numri të ISMN-së

Një numër i caktuar i ISMN-së nuk guxon të përdoret në asnjë rrethanë sërish. Kjo ka rëndësi të jashtëzakonshme pasi e shmang çfarëdo pështjellimi. Nëse një numër caktohet gabimisht, ai duhet të fshihet prej listës së numrave të përdorshëm dhe nuk duhet t'i caktohet ndonjë titulli tjetër. Botuesit posedojnë numra të mjaftueshëm në kuadër të serisë së numrave të ISMN-së të ndarë për ta, andaj është tejet e parëndësishme humbja e këtij numri të dhënë gabimisht.

Botuesit duhet ta njoftojnë agjencinë kombëtare apo rajonale për numrat e fshirë dhe për titujt të cilëve ua kanë caktuar gabimisht ata numra.

7. SHTYPJA DHE PROMOVIMI I ISMN-SË

ISMN-ja duhet të duket në vetë ekzemplar. Kjo ka rëndësi të madhe për menaxhimin efikas të sistemit, dhe se duhet të shtypet gjithmonë në një madhësi që mund të lexohet lehtë (9 pikë ose më të madhe).

7.1. Shtypja e ISMN-së në veprat muzikore

7.1.1. Vendi ku duhet të vendoset ISMN-ja

- Numri i ISMN-së duhet të shtypet në pjesën e prapme të partiturës apo pjesës.
- Nëse është praktike, ISMN-ja duhet të shtypet gjithashtu krahas me vërejtjen për të drejtën autoriale.
- Po qe se nuk mund të shtypet ISMN-ja në ndonjërin prej këtyre pozitave, atëherë ajo duhet të shtypet në ndonjë pozitë tjetër të dukshme (p.sh. në fund të faqes së parë të veprës muzikore).
- Në rast se ekzemplari përbëhet vetëm prej një flete, ISMN-ja duhet të shfaqet vetëm në një vend në ekzemplar.
- Nëse ekzemplari ka përmbajtje, e cila shfaqet përmes pajisjeve elektronike (p.sh. një ekzemplar elektronik onlajn), atëherë ISMN-ja duhet të paraqitet në faqen apo pamjen që e shfaq titullin apo elementet e tjera të ngjashme (p.sh. pamja fillestare që shfaqet është ajo kur i qasemi për herë të parë përmbajtjes së ekzemplarit dhe/ose pamja që e shfaq vërejtjen për të drejtën e autorit).

- Secili vëllim i një kompleti veprash shumëvëllimëshe duhet t'i renditë të gjithë numrat e ISMN-së që i përkasin atij vëllimi si dhe kompletit si tërësi. Një ekzemplar brenda kompletit po ashtu duhet ta renditë listën e numrave të ISMN-së për secilin ekzemplar tjetër të veçantë në atë komplet.
- Kur ekzemplari është antologji, ISMN-ja e antologjisë duhet të dallohet qartë prej cilitdo numër tjetër të ISMN-së që mund të shtypet në ekzemplar të veçantë, i cili përshihet në atë antologji.
- Nëse ekzemplari rendit ndonjë identifikues tjetër krahas atij të ISMN-së, këta numra duhet të shtypen afër njëri-tjetrit. Secilit numër standard ndërkombëtar duhet t'i paraprijë shkurtesa përkatëse (p.sh. shkronjat ISBN, ISSN, ISRC, ISAN, ISWC ose ISMN).

7.1.2. *Renditja e plotë e të gjithë numrave të ISMN-së që i takojnë një botimi*

Këshillohet që lista e plotë e numrave të ISMN-së, të cilët u janë caktuar të gjitha pjesëve përbërëse të një botimi, dhe të pasuara nga kualifikimi përkatës, të renditen në së paku njërin prej ekzemplarëve. Po qe se është e mundur, ajo listë duhet të renditet edhe në një apo më shumë ekzemplarë të tjerë.

Shembuj:

- ISMN 979-0-3217-6543-6 (partiturë⁶)
- ISMN 979-0-3217-6544-3 (partiturë vokale)
- ISMN 979-0-3217-6545-0 (komplet i pjesëve)

Kjo listë duhet të renditet së paku në partiturë, dhe preferohet që të renditet edhe në partiturën vokale, e mbase edhe në secilën pjesë.

- ISMN 979-0-3217-6546-7 (partiturë, e lidhur)
- ISMN 979-0-3217-6547-4 (partiturë, me lidhje të butë)

Kjo listë duhet të renditet si në versionin e lidhur ashtu edhe në atë me lidhje të butë.

- ISMN 979-0-3217-6548-1 (komplet)
- ISMN 979-0-3217-6549-8 (vëll. 1)
- ISMN 979-0-3217-6550-4 (vëll. 2)
- ISMN 979-0-321-76551-0 (vëll. 3)

Kjo listë duhet të renditet në të tri vëllimet; së paku numri i ISMN-së i kompletit dhe i vëllimit aktual duhet të renditet në secilin vëllim. Për botimet shumëvëllimëshe shih seksionin 6.5.

Nëse një komplet i pjesëve shpërndahet në mbështjellës, atëherë ISMN-ja e kompletit duhet të shtypet në mbështjellës. Nëse pjesët janë të veçanta, atëherë ISMN-ja e secilës pjesë të veçantë duhet të shtypet në mbështjellës.

⁵ Shprehjet identifikuese pas numrave të ISMN-së kanë qëllim ilustrues dhe jo normativ. Ato jepen në gjuhën e botimit.

7.2. *Shtypja e ISMN-së në kod të lexueshëm prej pajisjeve kompjuterike*

Për qëllim të OCR-së⁷, ISMN-ja duhet të shtypet në formatin OCR-B. Përhapja e shpejtë e leximit të barkodit ka bërë të mundur shfrytëzimin e barkodit ndërkombëtar trembëdhjetë-shifrorë. Të gjitha këto barkode fillojnë me një identifikues shtetëror, përveç atyre që përdoren në libra, periodikë dhe në veprat muzikore. Për shkak të rrjetit ndërkombëtar të tregtisë me libra, shifrat 978 dhe 979-1 deri në 979-9 për libra, 979-0 për veprat muzikore dhe 977 për periodikë konsiderohen si prefiks që e tregojnë vendin fiktiv të prejardhjes së këtyre materialeve.

ISMN-ja 13-shifrore është identike me shifrën e ISMN-së që përdoret në barkod.

ISMN-ja e shtypur me simbolet e barkodit duket si vijon:



⁵ OCR – Optical Character Recognition – njohja optike e karaktereve.

7.3. Furnizimi me barkode 13-shifrore

Udhëzime për prodhuesit e etiketave të barkodeve

Për t'i furnizuar botuesit me etiketa të barkodeve të ISMN-së në mënyrë që t'i shtypin në produktet e tyre duhet të ndiqen procedurat në vijim:

- Vlerësoni vlefshmërinë e ISMN-së të dhënë nga botuesit, duke e aplikuar rutinën e vlerësimit të vlefshmërisë së shifrës së kontrollit të ISMN-së në mënyrë që t'i shmangemi gabimeve të përshkrimit apo transponimit (shih algoritmin e llogaritjes së shifrës së kontrollit të ISMN-së).
- Shtypni:
 1. ISMN-në në numra që lexohen prej syrit të njeriut (OCR-B),
 2. ISMN-në me prefiksin e vendit fiktiv në barkod,
 3. ISMN-në me prefiksin e vendit fiktiv në numra që lexohen prej syrit të njeriut.

Të gjitha këto procedura duhet të kryhen përmes programeve kompjuterike. Duhet të respektohen standardet teknike të EAN për shtypjen e barkodit.

Numrat e ISMN-së që shtypen në format të lexueshëm prej pajisjeve kompjuterike u nënshtrohen gjithashtu rregullave të përcaktuara në këtë doracak. Për shkak se ekziston një numër i madh i rregullave dhe i rekomandimeve shtesë paraqitet nevoja që ata që dëshirojnë ta shtypin ISMN-në në format që mund të skanohet të kërkojnë këshilla tek agjencia e tyre kombëtare lidhur me emrat e prodhuesve të barkodeve që veprojnë në territorin e tyre.

7.4. *Promovimi i ISMN-së*

ISMN-të duhet të jenë të pranishme në reklamat e botuesve, në katalogët dhe listat e botimeve të mëhershme; ato duhet të jenë të pranishme në fletushka, broshura dhe në të gjitha materialet e tjera reklamuese dhe të marketingut.

Këshillohet që në materialet e tilla ISMN-ja të shtypet në një vend të dukshëm afër titullit dhe përshkrimit të ekzemplarit.

Numri i plotë i ISMN-së duhet të jepet gjithmonë, edhe pse është e pranueshme që të mos i shtypim shkronjat <<ISMN>> për aq sa është e qartë se ai numër është Numri Standard Ndërkombëtar i Muzikës.

8. **ADMINISTRIMI I SISTEMIT TË ISMN-SË**

Administrimi i ISMN-së bëhet në tri nivele, në atë: a) ndërkombëtar, b) kombëtar ose rajonal, dhe c) të botuesit.

8.1. *Administrimi ndërkombëtar*

Administrimi ndërkombëtar i sistemit bëhet prej Agjencisë Ndërkombëtare të ISMN-së, e cila është një shoqatë me anëtarësim. Të gjitha agjencitë e ISMN-së duhet të jenë anëtare të saj.

Organet udhëheqëse të shoqatës janë *bordi*, dhe *kuventi i përgjithshëm*. Bordi përbëhet prej tre anëtarëve: kryetarit, nënkryetarit, dhe arkëtarit. Kryetari ose nënkryetari e përfaqësojnë shoqatën. Arkëtari e përfaqëson shoqatën së bashku me njërin prej dy anëtarëve të bordit. Për t'i përmbushur detyrat e veta, bordi mund të kërkojë ndihmë prej ndonjë pale të tretë.

Bordi udhëheq me veprimtarinë e shoqatës dhe është përgjegjës për të gjitha çështjet, të cilat nuk janë përgjegjësi e ndonjë organi tjetër në kuadër të shoqatës. Në radhë të parë është përgjegjës që:

- a) të përgatitet për kuvendin e përgjithshëm, ta hartojë rendin e ditës, dhe ta thërret mbledhjen e tij;
- a) ta paraqet pasqyrën vjetore financiare dhe raportin e punës;
- a) ta paraqet buxhetin;
- a) ta caktojë drejtuesin e agjencisë.

Takimi i përgjithshëm vjetor i merr të gjitha vendimet, e kontrollon buxhetin dhe është veçmas përgjegjës për:

- a) zgjedhjen e bordit dhe të dy auditorëve të brendshëm;
- b) vendimet sa i përket propozimeve të dorëzuara nga bordi;
- c) caktimin e pagesave të anëtarësisë;
- d) miratimin e planit buxhetor;
- e) miratimin e procesverbalit të mbledhjes së fundit të kuvendit të përgjithshëm;
- f) caktimin e një auditori të jashtëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare;
- g) pranimin dhe miratimin e raportit vjetor dhe të pasqyrave vjetore financiare;
- h) shkarkimin e bordit;
- i) vendimet sa i përket ndryshimeve të statuteve;
- j) marrjen e vendimit për shpërbërjen e shoqatës.

Adresa e Agjencisë Ndërkombëtare të ISMN-së është:

Internationale ISMN-Agentur (International ISMN Agency)

Schlossstr. 50

12165 Berlin (Germany)

tel.: +49 30 7974 5002

fax: +49 30 7974 5254

e-mail: ismn@ismn-international.org

<http://ismn-international.org>

Funksionet kryesore të Agjencisë Ndërkombëtare të ISMN-së janë:

- mbikëqyrja se si po përdoret sistemi;
- miratimi i përzgjedhjes, emërimit dhe strukturës së agjencive kombëtare dhe rajonale;
- ndarja e numrave identifikues të ISMN-së për agjencitë kombëtare dhe rajonale;
- këshillimi i agjencive kombëtare ose rajonale për ndarjen e elementit, përkatësisht identifikuesit, të botuesit;
- promovimi i sistemit të ISMN-së për përdorim anëmbanë botës;
- përzgjedhja e bordit ndërkombëtar të ISMN-së në përbërje të ekspertëve të cilët kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve;
- Shkëmbimi i informatat përmes botimeve dhe takimeve rajonale;
- botimi dhe përditësimi i doracakut me udhëzime për përdorimin e ISMN-së;
- bashkërendimi për aplikimin e barkodit të ISMN-së.

Përveç kësaj, Agjencia Ndërkombëtare e ISMN-së i ofron edhe këto shërbime:

- do ta furnizojë agjencinë kombëtare ose rajonale me lista të numrave të ISMN-së (ku shifra e kontrollit gjenerohet me anë të kompjuterit) që do të shfrytëzohen prej botuesve në territorin e asaj agjencie, përkatësisht do ta pajisë me softuer të nevojshëm për gjenerimin e numrave të tillë;
- do ta krijojë një udhëzues të botuesve të muzikës prej informatave që i merr prej agjencive kombëtare dhe rajonale;
- do ta krijojë një listë të numrave të pavlefshëm ose dublikatë të ISMN-së përmes kompjuterit prej informatave që i merr prej agjencive kombëtare dhe rajonale (nëse paraqitet nevoja).

8.2. *Administrimi kombëtar ose rajonal*

Caktimi i elementit identifikues të botuesve dhe lidhja e botuesve me sistemin e ISMN-së menaxhohet kryesisht prej agjencive kombëtare ose rajonale. Agjencitë kombëtare ose rajonale emërohen prej Agjencisë Ndërkombëtare të ISMN-së sipas një marrëveshjeje me anë të së cilës zyrtarizohet anëtarësimi i tyre.

Funksionet e agjencisë kombëtare ose rajonale janë:

- i mirëmban kontaktet me botuesit në vendin ose rajonin ku vepron si dhe i përfshinë botuesit e rinj në sistemin e ISMN-së;
- imenaxhon marrëdhëniet me Agjencinë Ndërkombëtare të ISMN-së në emër të botuesve të vendit ose rajonit ku vepron;

- vendos, në konsultim me organizatat tregtare dhe me botuesit, për serinë e nevojshme të elementeve, përkatësisht numrave identifikues, të botuesit;
- ia ndan elementin e botuesit atyre botuesve që i plotësojnë kriteret për regjistrim në sistemin e ISMN-së së vendit ku veprojnë, si dhe e mirëmbanë një regjistër të këtyre botuesve së bashku me elementet e tyre identifikuese;
- vendos, në konsultim me organizatat tregtare dhe me botuesit, se cilët botues do t'i caktojnë vetë numrat e ISMN-së për botimet e tyre, dhe cilëve botues do t'ua caktojë agjencia kombëtare ose rajonale numrat e ISMN-së botimeve të tyre;
- u ofron botuesve këshilla dhe ndihmë teknike për ta siguruar respektimin e standardeve dhe të procedurave të miratuara;
- ua ofron botuesve doracakun me udhëzime të ISMN-së në gjuhën amtare;
- u ofron lista të gatshme me numra të ISMN-së, përfshirë edhe llogaritjen e numrit të kontrollit, të gjithë botuesve që ia vënë vetë numrin e ISMN-së botimeve të tyre;
- e kontrollon vlefshmërinë e të gjithë numrave të ISMN-së që botuesit ia kanë caktuar botimeve të veta dhe e mirëmban një regjistër të tyre;
- i informon botuesit lidhur me numrat e pavlefshëm ose dublikatë të ISMN-ve të cilat ia kanë vënë botimeve të veta;
- u cakton numra të ISMN-së të gjitha botimeve të botuesve që nuk ua caktojnë vetë numrin e ISMN-së, dhe i këshillon këta botues lidhur me numrat e caktuar për ta;

- arritja e shkallës kur të gjitha botimet marrin numër të ISMN-së prej agjencisë kombëtare ose rajonale brenda territorit në të cilin vepron;
- bashkëpunon me agjencitë që merren me listat muzikore dhe me agjencitë bibliografike që t'i botojnë të gjithë numrat e ISMN-së krahas titujve të cilët u referohen;
- bashkëpunon me botuesit që t'u caktojnë numra të ISMN-së botimeve të veta të mëhershme, dhe të cilat dëshirojnë t'i ribotojnë, si dhe të sigurohen që këta numra të botohen në listat përkatëse të sistemit tregtar muzikor dhe në bibliografitë përkatëse;
- i ndihmon sistemit tregtar që ta përdorin numrin e ISMN-së në sistemet e tyre kompjuterike;
- ia dërgon rregullisht dhe pa pagesë Agjencisë Ndërkombëtare të ISMN-së të dhënat e plota të prefikseve dhe adresave të të gjithë botuesve që t'i përfshirë pastaj në Udhëzuesin e Botuesve Muzikorë të ISMN-së;
- e informon rregullisht Agjencinë Ndërkombëtare të ISMN-së lidhur me aktivitetet e veta dhe me gjendjen aktuale të sistemit të ISMN-së në vendin ose rajonin ku vepron;
- kontribuon financiarisht në mbarëvajtjen e Agjencisë Ndërkombëtare të ISMN-së.

9. ISMN-JA DHE NUMRAT E TJERË STANDARDË NDËRKOMBËTARË

9.1. ISBN-ja

Disa prej materialeve muzikore mund të shpërndahen edhe përmes rrjetit tregtar të librit. Botuesit që botojnë materiale muzikore me qëllim të shpërndarjes së tyre përmes rrjetit tregtar të librit mund t'ia caktojnë materialit të tyre një numër të ISBN-së (Numri Standard Ndërkombëtar i Librit) krahas numrit të ISMN-së. Nganjëherë e kemi të vështirë që të vendosim nëse një botim (si libra këngësh, libra himnesh fetare, apo një album me tekst të zgjeruar ose ilustrues) është vepër muzikore, libër “normal”, apo të dyja këto. Në këto raste botimit mund t'i vihen edhe ISMN-ja edhe ISBN-ja. Nëse botuesi dëshiron ta përdorë vetëm njërin prej numrave atëherë zgjidhja i mbetet vetë botuesit, porse preferohet që të përdoret ISMN-ja në raste të këtilla.

Aplikimi i ISBN-së është përshkruar në një doracak të veçantë. Sistemi i ISBN-së administrohet prej Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së, grupeve të agjencive dhe agjencive kombëtare. Adresa e Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së është:

International ISBN Agency

c/o EDItEUR

39-41 North Road

London N7 9DP

United Kingdom

tel: +44 (0) 207 607 0021

fax: +44 (0) 207 607 0415

e-mail: info@isbn-international.org

<http://www.isbn-international.org>

Në rastet kur si ISMN-ja dhe ISBN-ja u caktohen njëkohësisht një botimi, ato duhet të shtypen në ekzemplarë dhe të identifikohen qartë prej njëra-tjetrës.

9.2. *ISSN-ja*

Përveç ISMN-së dhe ISBN-së, ekziston edhe një sistem tjetër për numërimin e burimeve të vazhdueshme (më parë të quajtura: botime serike), d.m.th. ISSN-ja – Numri Standard Ndërkombëtar i Botimeve Serike.

Një pjesë e burimeve të vazhdueshme – botimet serike përkufizohen si secili botim, pa marrë parasysh mediumin, që del në pjesë të njëpasnjëshme dhe që shpesh identifikohet ose në aspektin numerik ose në aspektin kronologjik dhe ka për qëllim të botohet për një periudhë të pacaktuar. Botimet serike duhet të dallohen prej botimeve shumëvëllimëshe, për të cilat parashihet numri i vëllimeve që do të botohen (shih seksionin 6.5).

Në botimet serike përfshihen si periodikët ashtu edhe seritë/koleksionet. Ka vetëm pak periodikë që merren vetëm me vepra muzikore, porse shumë prej botimeve muzikore dalin si seri, përkatësisht koleksion. Të dy kategorive u caktohen numra të ISSN-së për titullin serik (i cili mbetet i njëjtë për të gjithë numrat e periodikut apo vëllimit individual të një serie), dhe një ISMN për secilin ekzemplar të veçantë në atë seri. (Nëse titulli i serisë ndryshon, atëherë duhet t'i caktohet një numër tjetër i ISSN-së).

Sistemi i ISSN-së, i cili njihet me emrin Rrjeti i ISSN-së, administrohet prej Qendrës Ndërkombëtare të ISSN-së, me adresë:

ISSN International Centre

45, Rue de Turbigo

75003 Paris

France

tel.: +33 1 44 88 22 20

fax: +33 1 40 26 32 43

e-mail: issnic@issn.org

<http://www.issn.org>

Botuesit e burimeve serike duhet të aplikojnë në Qendrën Ndërkombëtare të ISSN-së ose në qendrën e tyre kombëtare të ISSN-së, nëse ka një të tillë, për t'u pajisur me numër të ISSN-së. Botuesit nuk mund t'i caktojnë vetë numrat e ISSN-së për botimet e tyre.

Në rastet kur si SIMN-ja dhe ISSN-ja u caktohen njëkohësisht një botimi, ato duhet të shtypen në botim dhe të identifikohen qartë prej njëra-tjetrës.

9.3. ISRC-ja

ISMN-ja nuk është krijuar për t'i numëruar incizimet zanore apo video-incizimet – përveç në rastet kur janë pjesë e një vepre muzikor (shih seksionin 3). Me Kodin Standard Ndërkombëtar të Incizimeve (ISRC - International Standard Recording Code) numërohet secili incizim i një pjese (por shpesh jo edhe secili ekzemplar), pa marrë parasysh kontekstin apo mbështjellësin në të cilin botohet. ISRC-ja mund t'i kodohet një produkti si vulë e përhershme digjitale. ISRC-ja administrohet nga IFPI (Federata Ndërkombëtare e Prodhuesve të Fonogrameve dhe Videogrameve - International Federation of Phonogram and

Videogram Producers):

International ISRC Agency
c/o IFPI Secretariat
10 Piccadilly
London E1J 0DD
United Kingdom
tel: +44 (0)20 7878 7950
fax: +44 (0)20 7878 6832
e-mail: isrc@ifpi.org
<http://www.ifpi.org/isrc>

9.4. ISWC-ja

Kodi Standard Ndërkombëtar i Veprave Muzikore (ISWC) (ISO 15707) është një sistem numërimi i cili e mundëson identifikimin e veprave muzikore (termi i përdorur këtu “vepër” i referohet si i tillë veprës si krijim, e jo si manifestim, ri-botim apo ekzemplar i një veprë të caktuar). Është një sistem i pazëvendësueshme sa i përket menaxhimit të së drejtës autoriale. Kodi ISWC fillon me shkronjën <<T>>, i cili pasohet prej një vargu prej nëntë shifrave dhe shifrës së kontrollit në fund të vargut. Kodi i ISWC-së qëndron me veprën muzikore të cilës i është caktuar në nivel mbarëbotëror. Çfarëdo veprë muzikore, e botuar ose e pabotuar, e krijuar rishtazi apo ekzistuese, kualifikohet për kod të ISWC-së. E njëjta gjë vlen edhe për aranzhimet muzikore. ISWC-ja administrohet prej:

CISAC
20/26 Boulevard du Parc
92200 Neuilly-sur-Seine
France
tel: +33 1 55 62 08 50
fax: +33 1 55 62 08 60
e-mail: info@iswc.org
<http://www.iswc.org>

9.5. ISAN-i

Numri Standard Ndërkombëtar Audio-vizual (ISAN) (ISO 15706) aplikohet për të gjitha veprat audio-vizuale. Termi <<vepër audio-vizuale>> nënkupton çfarëdo vepre e cila përbëhet prej një vargu të animuar të imazheve, pa marrë parasysh nëse shoqërohet me ose pa zë. Numri ISAN i identifikon veprat, e jo publikimet apo transmetimet si paraqitje e tyre fizike. ISAN-i ua bën të mundur të gjithë pronarëve të të drejtave autoriale (autorëve, interpretuesve, prodhuesve) t'i identifikojnë veprat audio-vizuale.

ISAN-i administrohet prej:
ISAN International Agency
1A, rue de Beulet
1203 Geneva
Switzerland
tel: +41 22 5451000
fax: +41 22 545 1040
e-mail: info@isan.org
<http://www.isan.org>

9.6. DOI

DOI (Identifikuesi i Objekteve Digjitale) është krijuar prej industrisë botuese me qëllim që t'i identifikojnë botimet elektronike, veçanërisht të atyre në formë onlajn, për t'u shfrytëzuar në rrjetet digjitale. Vendosja e DOI-t në përmbajtje e rrit mundësinë e prodhuesit të asaj përmbajtje ta realizojë tregtinë me të në formë elektronike. Mundëson menaxhim efikas të përmbajtjes së objekteve digjitale të çfarëdo forme, i lidh konsumatorët me furnitorët e përmbajtjes, e ndihmon tregtinë elektronike, si dhe mundëson menaxhim të automatizuar të së drejtës autoriale për të gjitha llojet e mediave.

DOI administrohet prej:
International DOI Foundation
5, Linkside Avenue
Oxford, OX2 8HY
United Kingdom
tel: +44 1865 559070
e-mail: contact@doi.org
<http://www.doi.org>

DOI përshtatet me ISMN-në: mund ta integrojë ISMN-në dhe identifikuesit e tjerë standard që përdoren në industrinë botuese.

9.7. URN-ja

URN-të (Emrat Uniform të Burimeve) janë identifikues të përhershëm të burimeve informative. Grupi Punues i Inxhinierëve të Internetit (IETF – Internet Engineering Task Force) filluan me këtë iniciativë në vitin 1996, duke e emëruar grupin punues të URN-së.

URN-ja është një sistem ombrellë, i cili mund ta integrojë në vete çfarëdo sistemi ekzistues të identifikuesve, duke e përfshirë edhe DOI-n. Secila URN përbëhet prej tri pjesëve: vargu i karaktereve <<urn:>>, identifikuesi i hapësirës së emrit (NID), dhe vargu specifik i hapësirës së emrit (NSS), ashtu siç është specifikuar në standardin e Internetit RFC 2141. NSS-ja përbëhet prej një identifikuesi, si ISMN-ja. Identifikuesi i hapësirës së emrit është emër unik, i regjistruar për sistemin identifikues që përdoret si URN.

URN-të mundësojnë shërbime të besueshme të zgjidhjes së problemeve në Internet. Me të është e mundur që të gjendet ose vetë burimi, përshkrimi i tij, ose një listë e URL-vë, të cilat mundësojnë gjetjen e dokumentit. Nga këndvështrimi i përdoruesve, përdorimi i URN-së është i lehtë: përdoruesit e ardhshëm mund ta shkruajnë URN-në në vend të URL-së në rubrikën përkatëse të shfletuesit të internetit. Ky shërbim bazohet në shërbimet standarde të Internetit HTTP dhe në shërbimin e domenit të emrit – DNS.

10. SHTOJCA: ISMN-JA DHJETËSHIFRORE

Në pesëmbëdhjetë vjetëte para të ekzistimit, ISMN-ja kishte formë dhjetëshifrore. Elementi i parë ishte një konstante<<M>>, e cila e nënkuptonte *Muzikën*. Për ta kthyer një numër trembëdhjetëshifrorë të ISMN-së në një numër dhjetëshifrorë, duhet ta zëvendësoni numrin fillestar <<979-0>> me konstanten <<M>>.

Për ta kthyer një numër dhjetëshifrorë të ISMN-së në numër trembëdhjetëshifrorë, duhet ta zëvendësoni konstanten <<M>> me numrin <<979-0>>.

Rishikimi i standardit ishte i nevojshëm meqë kishte ndryshuar edhe struktura e ISBN-së. Meqë shumë prej aplikimeve, posaçërisht në fushën e shpërndarjes, e kishin ndjekur shembullin e komunitetit të ISBN-së, atëherë numrat dhjetëshifrorë të ISMN-së u bënë problematikë. Prandaj, formati prej trembëdhjetë shifrave mundëson që ISMN-ja të jetë në përputhje me aplikacionet softuerike që përdoren në fushën e tregtisë.


10.1. Riformatizim i ISMN-së

Këshillojmë botuesit që t'i ndryshojnë plotësisht fajllat e tyre në numra 13-shifrorë të ISMN-së. Nuk ka nevojë të ndryshohen numrat e ISMN-së nëpër udhëzues të ndryshëm, katalogë të bibliotekave, bibliografi kombëtare, etj.

Botuesit dhe shitoret muzikore mund të përdorin fletë ngjitëse për veprat muzikore në mënyrë që ta shfaqin numrin e ri të ISMN-së dhe barkodet e tyre.

SHTOJCA

A. Rrjeti i standardeve



ISNI	International Standard Name Identifier	- Identifikuesi Standard Ndërkombëtar i Emrit
ISWC	International Standard Musical Work Code	- Kodi Standard Ndërkombëtar i Veprave Muzikore
ITC	International Standard Textual Work Code	- Kodi Standard Ndërkombëtar i Veprave Tekstuale
ISAN	International Standard Audiovisual Number	- Numri Standard Ndërkombëtar Audio-vizual
ISMN	International Standard Music Number	- Numri Standard Ndërkombëtar i Muzikës
ISBN	International Standard Book Number	- Numri Standard Ndërkombëtar i Librit
ISSN	International Standard Serial Number	- Numri Standard Ndërkombëtar i Botimeve Serike

ISRC	International Standard Recording Code	-	Kodi Standard Ndërkombëtar i Incizimeve
URN	Uniform Resource Name	-	Emri Uniform i Burimeve
NBN	National Bibliography Number	-	Numri i Bibliografive Kombëtare
DOI	Digital Object Identifier	-	Identifikuesi i Objekteve Digjitate

B.1 Metadatat minimale për ISMN-në

Agjencia e regjistrimit të ISMN-së apo agjencia përkatëse bibliografike duhet t'i mirëmbajë metadatat që lidhen me secilin numër të dhënë të ISMN-së.

Meqë agjencitë për regjistrimin e ISMN-së menaxhohen prej bibliotekave kombëtare, qendrave bibliografike dhe asociacioneve tregtare, ato duhet t'i përdorin kodet e përshkrimit bibliografik të bibliotekave, përkatësisht skemat më të zgjeruara të metadatave për udhëzuesit apo direktoriumet tregtare. Më poshtë e kemi dhënë një shembull të metadatave themelore që duhet të krijohen dhe mirëmbahen.

Metadatat minimale:

Elementi i të dhënave	Komente
ISMN-ja	Numri i ISMN-së të cilin ia ka caktuar agjencia përkatëse e ISMN-së
Formati i produktit	Kod me të cilin tregohet mediumin dhe/ose formati i produktit
Titulli	Titulli i botimit, së bashku me nëntitullin (nëntitujt), nëse ka të tillë
ISWC	Kodi i ISWC-së i përmbajtjes së veprës muzikore, nëse ka të tillë

Titulli i serisë/koleksionit dhe numërimi	Nëse ka
Kontribuuesi	Kodi i rolit të kontribuuesit dhe emri (emrat) i kontribuuesit
Edicioni	Numri i edicionit/ribotimit (për botimet pas të parit), lloji dhe fusha e ribotimit
Gjuha (gjuhët) e tekstit	Të përdoren kodet e gjuhës ISO 639-2/B
Emri i brendit të botimit	Emri, brendi, nën të cilën është botuar një vepër
Formati i veprës muzikore	Formati i veçantë i veprës muzikore, i cila e dallon atë prej formateve të tjera të veprës së ngjashme (p.sh: partiturë; partiturë dhe kompletë të pjesëve)
Botuesi	Personi ose organizata që njihet si pronare e botimit në datën e botimit
Vendi i botimit	Të përdoren kodet e vendit ISO 3166-1
Data e botimit	Data e botimit të parë me këtë ISMN. Të përdoret formati ISO 8601 (VVVV—MM—DD)
Numri i regjistrimit (muzikë)	Posaçërisht kur numri i regjistrimit përbëhet prej një pjese të numrit të ISMN-së. (nëse ka)
ISMN-ja e botimit kryesor	ISMN-ja e botimit kryesor pjesë e të cilës është edhe ky botim, nëse ka (p.sh. Partitura kryesore dhe pjesët e veçanta të saj).

B. 2. ONIX-i

ONIX-i është familje e standardeve të bazuara në XML për komunikimin e metadatave për libra, botime serike dhe media të tjera të publikuara. ONIX-in e ka zhvilluar dhe e mirëmbanë EDItEUR, një organ i standardeve ndërkombëtare të botimit, në partneritet me një varg organizatash të tjera.

Standardi i ONIX-it për Libra është një standard ndërkombëtar për ta përfaqësuar dhe për ta ndihmuar komunikimin e informacionit të produkteve të industrisë së librit në forma-

tin elektronik. Standardi u zhvillua si reagim ndaj nevojës për të transmetuar informata të pasuruara të produktit në formë elektronike dhe me një format standard mes botuesve, agjencie bibliografike, shitësve me shumicë dhe librashitësve. Me këtë ndihmohet që informacioni i produktit të përpunohet në mënyrë automatike nëpër katalogë, ueb-sajta të shitjes së librave onlajn, si dhe në materiale të tjera promovuese. ONIX-i për libra është bërë standard i tregtisë së librit në shumë vende, duke përfshirë Australinë, Kanadanë, Finlandën, Francën, Gjermaninë, Italinë, Republikën e Koresë, Holandën, Norvegjinë, Rusinë, Spanjën, Suedinë, Mbretërinë e Bashkuar dhe ShBA-në.

Edhe ps ONIX-i për libra tash për tash nuk i përfshinë të gjitha elementet e parapara në metadatat minimale të ISMN-së, po qe se paraqitet nevoja mund të zhvillohet me mjaft lehtësi në të ardhmen edhe standardi i ONIX-it për veprat muzikore.

(Brian Greene ka shkruar tekstin për ONIX-in)

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

78(035)

Doracak: Numri Standard Ndërkombëtar i Muzikës /
redaktorë Edona Munishi – Kokollari, Fazli Gajraku
; përktheu Besim J. Kokollari.– Prishtinë : Biblioteka
Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”, 2015. – 51 f. :
ilustr. ; 21 cm

Titulli i origjinalit: ISMN Users' Manual. – Parathënie
/ Hartmut Walravens : f. 7

1. Munishi–Kokollari, Edona 2. Gajraku, Fazli
3. Kokollari, Besim J.

ISBN 978-9951-13-061-5